



I nderuar z.Taylor, Udhëheqës i zyrës së BERZH-it për Kosovë

Të nderuar përfaqësues të Ambasadave në Kosovë

Të nderuar përfaqësues të zyrës së BE-së në Kosovë

I nderuar zëvendësministër

Të nderuar kryetar të komunave

Të nderuar përfaqësues të institucioneve financiare vendore dhe ndërkombëtare

Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi e veçantë të ju mirëpresim në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të jemi pjesë e kësaj ngjarje të BERZH-it për prezantimin e Raportit të Tranzicionit për vitin 2021/2022. Kjo ngjarje dëshmon angazhimin dhe kontributin e rëndësishëm që BERZH-i në vazhdimësi ka dhënë për mbështetjen e institucioneve të Kosovës dhe në përgjithësi për zhvillimin ekonomik të vendit.

Si në gjithë botën, ashtu edhe në Kosovë, vitet e fundit kanë qenë mjaft sfiduese dhe të karakterizuara me një pasiguri të lartë, për sistemin financiar dhe për ekonominë e vendit. Si rezultat i kornizës rregullative adekuate si dhe standardeve të larta mbikëqyrëse, situata pandemike e gjeti sistemin financiar në Kosovë me nivele të larta të kapitalit dhe të likuiditetit si dhe kualitet shumë të mirë të mjeteve.

Gjithashtu, masat e kujdesshme të ndërmarra nga BQK-ja në bashkëpunim me institucionet financiare që operojnë në Kosovë janë treguar shumë efektive në ruajtje të stabilitetit financiar dhe minimizimit të pasojave për ekonominë e vendit në përgjithësi.

Si rezultat i këtyre masave, sektori bankar arriti ta ruaj shkallën e lartë të qëndrueshmërisë ndaj ndikimit të krizës dhe të përballoj shumë mirë sfidat dhe implikimet e pandemisë, dhe të luaj një rol shumë të rëndësishëm në rimëkëmbjen e ekonomisë përmes kreditimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të masave lehtësuese për kredimarrësit.

Aktualisht, norma e kredive jo-performuese në sektorin bankar qëndron në rreth 2.3%, përderisa norma vjetore e rritjes së kredive qëndron në 15.7%, gjë që tregon se po flasim për një sektor bankar të shëndoshë dhe me kontribut shumë të rëndësishëm në financimin e aktivitetit ekonomik.

Prioritet i yni mbetet që bankat të vazhdojnë ta ruajnë shkallën e lartë të qëndrueshmërisë, andaj rreziku kreditor vazhdon të jetë në fokus të BQK-së edhe në vitin 2022, sidomos duke u përqendruar në vlerësimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut kreditor, adekuatshmërisë së provizioneve për humbjet nga kreditë dhe menaxhimit të kredive me vonesa.

Ekonomia e Kosovës ka shënuar një rikuperim mjaft të suksesshëm në vitin 2021, pas një viti sfidues me vështirësi të theksuara që u shkaktuan nga masat për parandalimin e pandemisë COVID-19. Vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë se ekonomia e vendit në vitin 2021 shënoi një normë reale të rritjes prej 10.5%.

Ndikim të rëndësishëm në rritje të aktivitetit ekonomik patën masat e relaksimit të lëvizjes, të cilat rritën në masë të madhe vizitat e diasporës tonë në Kosovë, vizita

këto të cilat paraqesin një burim mjaft të rëndësishëm të financimit për ekonominë e vendit

Koncepti i tranzicionit i elaboruar nga raporti i BERZH-i argumenton në mënyrë të drejtë se një ekonomi e tregut që funksionon mirë duhet të jetë konkurruese, gjithëpërfshirëse, e mirë-qeverisur, miqësore ndaj mjedisit, e qëndrueshme dhe e integruar. Ne i mirëpresim konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga raporti i tranzicionit dhe vlerësojmë se janë një udhërrëfyes i mirë për perspektivën ekonomike të Kosovës.

Vëmendje të veçantë raporti i kushton digjitalizimit, i cili është duke e transformuar edhe sistemin financiar në mbarë botën. Procesin e transformimit digjital ne e shohim si një mundësi që institucionet financiare të bëhen më efikase si dhe të përmirësojnë qasjen në shërbimet financiare për ekonomitë familjare dhe bizneset.

Sa i përket fushës së pagesave, BQK-ja ka bërë disa hapa të rëndësishëm në liberalizimin e tregut, ku pagesat dhe shërbimet e transfereve të parave janë lejuar të ofrohen edhe nga institucione financiare jo-bankare. BQK-ja ka planifikuar që të liberalizojë edhe më tutje tregun e shërbimeve të pagesave duke adoptuar direktivën e BE-së për shërbimet e pagesave të njohur si PSD2, si dhe dy direktivat e BE-së që adresojnë llogaritë e pagesave dhe paratë elektronike, në kuadër të ligjit të ri për shërbimet e pagesave.

Për fund, më lejoni që edhe një herë të shpreh vlerësimin tim më të lartë për BERZH-in, e cila në vazhdimësi është dëshmuar si mbështetëse shumë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe promotor i reformave strukturore në ekonominë e vendit.